



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA  
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIU DHËN  
01.01.2022 DERI 30.06.2022, BASHKIA MAT”**

**Tiranë 2023**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”



### PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE</b> .....	<b>4</b>
<b>I/1. Hyrje</b> .....	<b>4</b>
<b>I/2. Objekti i Auditimit</b> .....	<b>4</b>
<b>I/3. Qëllimi i Auditimit</b> .....	<b>4</b>
<b>I/4. Metodologjia e Auditimit</b> .....	<b>4</b>
<b>I/5. Konkluzioni</b> .....	<b>5</b>
<b>II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË MAT</b> .....	<b>5</b>
<b>III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:</b> .....	<b>25</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

### Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik



## **KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT**

### **Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”**

#### **I. PËRMBLEDHJE**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 370, datë 18.04.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, në ambientet e Bashkisë Mat, më datë 25.05.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. L. B. dhe znj. E. K., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

#### **I/1. Hyrje**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 53/16 prot., datë 02.05.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Mat, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. E. K., përgjegjës grupi;
2. L. B., anëtar.

Auditimi ka filluar më datë 24.04.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 25.05.2023.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”.

#### **I/2. Objekti i Auditimit**

Bazuar në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ky auditim ka si objektiv, verifikimin në subjekt (*terren*) zbatimin konkret të rekomandimeve të KLSH, pasqyrimin e rasteve të shmangies nga këto rekomandime (*sidomos ato me impakt negativ financiar në buxhet*) dhe vlerëson aspektet e vendimmarrjes së Titullarëve të Institucioneve Publike, në drejtim të rritjes së performancës, me synim përmirësimin e metodës së punës, marrjen e masave të nevojshme strukturore, disiplinore apo ligjore shoqëruar me dëmshpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar buxhetit të shtetit, nga nëpunësit publikë përgjegjës të subjekteve të audituara.

#### **I/3. Qëllimi i Auditimit**

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të Raportit Vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### **I/4. Metodologjia e Auditimit**

Nëpërmjet dërgimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, KLSH realizon funksionin këshillues, duke respektuar pavarësinë institucionale, në përputhje me kërkesat e ISSAI 1, Deklarata e Limës “Udhëzime mbi rregullat e auditimit”, ISSAI 10, Parimi 7, Deklarata e Meksikos, “Ekzistencën e Mekanizmave efektive ndjekës në rekomandimet e SAI-ve”, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), për të rritur përgjegjshmërinë e nëpunësve publikë, në pranimin e përgjegjësive dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese dhe përmirësuar punën për të ardhmen i devijimeve nga standardet e pranuar dhe identifikimi i rasteve të shkeljes së parimeve të, ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, përputhshmëria



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

me kriteret e përcaktuara nga ligjet që rregullojnë funksionimin e njësive të pushtetit vendor, të menaxhimit financiar me qëllim përmirësimin e funksionimit të njësisë në të ardhmen.

#### I/5. Konkluzioni

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar gjithsej:

**b. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 20 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë zbatuar pjesërisht 6 masa, është në proces zbatimi 4 masë organizative dhe 1 masë nuk është zbatuar.**

**c1. Masa shpërblim dëmi është rekomanduar 1 masë e cila është zbatuar pjesërisht.**

**c2. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet, është rekomanduar 2 masa të cilat janë në proces zbatimi.**

**c3. Të ardhura të munguara, janë rekomanduar 11 masa, të cilat janë pranuar plotësisht, 2 masa nuk janë zbatuar dhe 9 masa janë zbatuar pjesërisht.**

**d. Masa administrative, i rekomandohet Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, shqyrtimin e informacionit për aktin abuziv në lidhje me aktivitetin financiar të shoqërive private. Ky rekomandim është zbatuar.**

**e. Masa disiplinore, i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë Mat vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe dhënien e masës disiplinore sipas rastit. Ky rekomandim nuk është zbatuar.**

## II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM NË BASHKINË MAT

**1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.**

**1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Mat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 53/16, datë 02.05.2022, ndërsa nga Bashkia Mat për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor.**

**Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Mat, ishin marrë masat si vijon:**

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë janë caktuar personat përgjegjës “Për hartimin e plan veprimit dhe akteve të tjera për zbatimin e rekomandimeve të KLSH;

*Zbatuar pjesërisht*

**2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Mat rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 53/16, datë 02.05.2022, dhe ka raportuar në KLSH brenda 6 muajve me shkresën nr. 2734/3 prot., datë 18.10.2022 brenda datës 02.11.2022 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin



## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

### **Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”**

brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

*Zbatuar*

#### **3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.**

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Mat ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 2684/1 datë 08.07.2022 dhe ka kthyer përgjigje brenda 6 muajve me shkresën nr. 2734/3 datë 18.10.2022 por nuk ka raportuar në këshillin e njësise (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësise së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësise për progresin në zbatimin e tij.

*Pa zbatuar*

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA të hartuara gjatë periudhës 2019-2021, u konstatua se:

-Për PBA 2019-2021 dhe PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Mat;

-Për PBA 2019-2021 dhe buxhetin vjetor 2019, Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin e Bashkisë, kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2019-2021, por në dosje administrohet vetëm VKB nr.34, datë 18.05.2018 për miratimin e taveve përgatitore për PBA 2019-2021, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2019-2021, Kryetari i Bashkisë Mat nuk ka marrë masat për të përgatitur dhe paraqitur për miratim në Këshillin e Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2019-2021, 2020-2022 dhe 2021-2023 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Buxheti vjetor i vitit 2019, nuk është miratuar brenda datës 25.12.2018, por është miratuar më datë 04.01.2019 me VKB nr.3, pra jashtë afatit;

-Për PBA 2019-2021 nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit brenda njësise së vetëqeverisjes vendore;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2019-2021 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mat, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Mat. **Nga verifikimi rezultoi se është ngritur Grupi i Menaxhimit Stragjetik me nr. 5750 prot., datë 31.12.2021. Në këtë urdhër është parashikuar se komisioni i mësipërm do të përgatisë buxhetin afatmesëm 2023 – 2025.**

**Zbatuar**

**1.2. Rekomandimi:** Për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Mat.

**Nga verifikimi rezultoi se: janë kryer konsultime me banorë të njëjësive administrative. U paraqitën listë prezenca mbi pjesëmarrjen në dëgjesat publike për paketën fiskale dhe PBA 2023 – 2025. Gjithashtu aktivitetet e zhvilluara janë pasqyruar edhe në rrjetet sociale.**

**Zbatuar**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave për investime të Bashkisë Mat, financiar nga Ministritë e Linjës, konstatohet se, në 3 raste në vlerën 2,247,632,489 lekë, janë ndërmarrë angazhime buxhetore duke lidhur kontratë me operatorë ekonomik, për investime në punë publike, pa pasur në dispozicion fondet e plota për realizimin e kontratës. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 1, 9, 10, 14 dhe 38 të nenit 3, nenin 40, nenin 50, nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 2 të VKM nr. 807, datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore”, i ndryshuar; Nenin 70 dhe nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Pikat 81, 142, 155, 165 në Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

**2.2 Nga verifikimi rezultoi se: përsa i përket këtij rekomandimi, investimet që kryhen me financim nga ministritë e linjës, vazhdojnë të jenë me fonde të shtrira ndër vite, pra nuk është e gjithë vlera e kontratës në dispozicion në llogarinë e autoritetit kontraktor.**

**Pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta në vitin 2019, konkretisht në masën 75%, në vitin 2020 duke ardhur me një rritje të tyre në masën 91%, si dhe duke vijuar me vitin 2021 në masën 88%. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se, nga Bashkia Mat në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore. Gjithashtu planifikimi i procedurave të prokurimeve nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se:** në planifikimin për investime dhe blerje mallrash, është bërë bazuar në realizimin e të ardhurave të vitit paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

*Zbatuar*

**4. Gjetje nga auditimi:** Përgjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se në 5 raste Bashkia Mat ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore pas datës 15 tetor, me vlerë totale 32,323,128 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme. Veprime e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme që të eliminohet praktikat e ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore përtej afatit ligjor.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se:** ky rekomandim është marrë parasysht pasi nga ana e bashkisë Mat pas datës 15 tetor nuk janë ndërmarrë angazhime të reja buxhetore.

*Zbatuar*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacion shoqëruar në Degën e Thesarit Mat, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2019-2021 ky afat nuk është respektuar në 563 raste për vlerën 279,939,309 lekë. Në fund të vitit 2021 detyrimi progresiv i Bashkisë Mat ndaj palëve të treta është në vlerën 316,892,067 lekë, nga të cilat krijuar brenda vitit 2021 gjithsej 57 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 309,026,173 lekë. Stoku i detyrimeve të prapambetura, pra për fatura të cilat nuk janë likuiduar brenda 60 ditëve kalendarike dhe vendimet gjyqësore, është në vlerën 32,115,797 lekë<sup>1</sup>. Në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të stokut të detyrimeve të prapambetura në vlerën 16,447,779 lekë.

-Gjithashtu sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në 6 raste nuk është respektuar rradha e likuidimit të tyre, pra detyrimi i parë likujdohet më parë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa për:

<sup>1</sup> Llogaria 467 dhe 401-408.





## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

-Sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit “hyrje e parë – dalje e parë”.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *ky rekomandim është marrë parasysh në lidhje me detyrimet e prapambetura pasi është ulur vlera e detyrimit në vitin pasardhës. Përjashtim bëjnë vetëm rastet e faturave për ndërhyrje në infrastrukturë me burim financimi Ministrinë e linjës.*

*Zbatuar pjesërisht*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Mat në marrëdhënien kontraktore me subjektin S. H., heqjen e fondit pyjor, lidhjen e kontratës së qirasë, etj, iniciuar nga ankesa e banorëve të NJA Derjan, mbi ndërtimin e HEC Sekë dhe Zais, administruar në KLSH me shkresën nr.82 prot., datë 17.01.2022, u konstatua se:

-Gjatë procesit të vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Mat, finalizuar me VKB nr.110, datë 20.12.2018, për miratimin e kërkesës për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqes së kërkuar nga subjekti S. H., nuk dokumentohet kryerja e seancave të konsultimit me publikun;

-Nuk është lidhur marrëveshje ndërmjet Bashkisë Mat dhe subjektit S. H. për ripyllëzimin e fondit pyjor dhe kullor të hequr, me qëllim mbrojtjen dhe rehabilitimin e tij, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “c” të pikës 2 në Urdhrin nr.25, datë 07.02.2019 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku përcaktohet:

-Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z. N. R., nuk ka respektuar detyrimin për të drejtën e informimit, sipas kërkesës nr.1921 prot., datë 16.07.2019 e bërë nga Komuniteti i Zall Gjocaj, Gjocaj, Dukagjin, Rukaj, Derjan, Macukull, Urzallë dhe Barbullej, drejtuar Bashkisë Mat, për vendosjen në dispozicion të projektit të HEC-eve dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis;

-Bashkia Mat përfaqësuar nga ish Kryetari i Bashkisë z.N. R., ka lidhur kontratë qiraje për shfrytëzimin e fondit pyjor dhe kullor, për ndërtimin e HEC-it, para se subjekti S. H., të pajisej me leje ndërtimi, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “f” të pikës 24 në Udhëzimin nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, të Ministrisë së Mjedisit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 2, pikën 2 të nenit 4, pikën 1 të nenit 16, pikat 1 dhe 2 të nenit 18, pikën 1 të nenit 26, pikat 5 dhe 6 të nenit 27, shkronjën “gj” të nenit 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 13 të nenit 2, pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 20, pikën 2 të nenit 22, pikën 1 të nenit 27/6 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar në fuqi në periudhën kur është shqyrtuar kërkesa dhe është lidhur kontrata e qirasë për fondin pyjor dhe kullor. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 132-135, të Raportit të Auditimit*)

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e druve të prerë në ekonominë pyjore Derjan 2 dhe Mbasdeje, nga punimet për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zajs, si dhe lidhjen e akt-marrëveshjes me subjektin “S. H.” për ripyllëzimin e fondit pyjor.

**6.2 Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Mat ka nxjerrë urdhërin me nr. 461 datë 20.06.2022, për kryerjen e vlerësimit në terren të materialit drusor të dëmtuar gjatë ndërtimit të veprave hidro-teknike të HEC-SEKA.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

Është mbajtur proces-verbali i vlerësimit në terren me datë 04.07.2022.

Struktura e pyjeve pranë Bashkisë Mat ka verifikuar dokumentat e rehabilitimit të sipërfaqes së hequr nga fondi pyjor/kullosor, ku rezultojnë dokumentat:

1- akt-marrëveshje me nr. 684 prot. datë 13.03.2019.

2- kontaktë pyllëzimi me dt. 13.03.2019.

3- Procerverbal dorëzimi i ngastrës ku do të kryhen pyllëzimi me dt. 13.03.2019.

4- Akt-marrjen në dorëzim të punimeve të pyllëzimit të ngastrës me dt. 14.03.2019.

Subjekti ka kryer të gjitha detyrimet për rehabilitimin e sipërfaqes së hequr nga fondi pyjor/kullosor.

Ndërsa referuar subjekteve A.-A. për ndërtimet e hec-Madhesh dhe hec-Traja, si dhe të subjektit D.-G. për ndërtimet e hec-Vinjoll dhe hec Mallunxa, rezulton se këto subjekte kanë hedhur në gjyq Bashkinë Mat duke kundërshtuar detyrimet financiare që kanë për kontratat e përdorimit të fondit Pyjor/Kullosor.

Përsa i përket subjektit “S. H.”, nga ana e Bashkisë Mat nuk janë marrë masat për të ngritur një grup me specialistë të fushës për të lidhur akt marrëveshjen me subjektin “S. H.” i cili rezulton se nuk ka paguar vlerën prej 710,597 lekë, detyrim ky ndaj Bashkisë Mat.

*Zbatuar pjesërisht*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se objektet, inventar i pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 800,075,612 lekë, nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

-llog 210 “Toka troje terrene”, elementë në vlerën neto 27,399,128 lekë

-llog. 211 “Pyje plantacione”, elementë në vlerën neto 10,550,203 lekë,

-llog. 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 103 objekte me vlerën neto 762,126,281 lekë

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 të nenit 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrë masat e nevojshme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**7.2 Nga verifikimi rezultoi se:** ky rekomandim është marrë parasysh në lidhje me pajisjen me titull pronësie të disa pasurive të paluajtshme dhe konkretisht gjatë periudhës prill 2022 - prill 2023 janë pajisur me titull pronësie 17 prona dhe është bërë kërkesa për t’u regjistruar 21 prona. Po bëhen përpjekje që të realizohen procedurat edhe për pasuri të tjera por mungesa e fondeve ka sjellë pamundësi për regjistrimin e të gjitha pronave.

*Zbatuar pjesërisht*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se shtesa në tabelën e gjendjeve të ndryshimit të aktiveve afatgjata materiale për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, ka qenë në vlerën 185,352,032 lekë, ndërsa sipas dokumentacionit shoqërues në urdhërshpenzimet e verifikuara në ditarët e bankës, disa prej faturave të sipërcituara nuk përbëjnë rritje aktivi sepse projekti përkatës në fund të vitit 2020 nuk ishte mbaruar si investim dhe nuk



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

ishte marrë në dorëzim, që do të thotë është një investim në proces. Pra shpenzimi kapital duhet të ishte regjistruar në llogarinë 231 “Shpenzime për rritjen e AAGJM”, specifikisht si më poshtë;

-Për vitin 2020: në llogarinë 231 “Shpenzime për rritjen e AAGJM” për shumën 185,352,032 lekë dhe jo në llogarinë e aktivitetit 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Theksojmë se jo çdo shpenzim investimi mund të kapitalizohet në aktivin përkatës për të cilin po bëhet investimi, dhe në rastin tonë janë ndërtesat dhe konstruksionet si dhe rrugët dhe veprat ujore. Vetëm shpenzimet kapitale të cilat janë situacione përfundimtare dhe për të cilat është marrë në dorëzim objekti, atëherë kapitalizohet e gjithë vlera e tij të llogaria e aktivitetit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “d” pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)

**8.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përkatësisht për shumën 185,352,032 lekë për vitin 2020, me mbylljen e bilancit kontabël të vitit të ardhshëm.

**8.2 Nga verifikimi rezultoi se:** ky rekomandim është zbatuar dhe janë bërë sistemimet përkatëse në Bilancin e vitit 2021 dhe vitit 2022.

*Zbatuar*

**9. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në fund të vitit 2020 në vlerën neto 30,066,269 lekë ndërsa në fund të vitit 2019 në vlerën neto 22,122,269 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të 5 projekteve infrastrukturore me vlerë 7,944,000 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 30,066,269 lekë dhe përbëhet nga 19 projekte për investime të kryera, nga të cilat 12 prej tyre nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik, si dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “d” pika 2.1 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rivlerësohet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 30,066,269 lekë.

**9.2 Nga verifikimi rezultoi se:** ky rekomandim është marrë përsysh dhe janë bërë sistemimet përkatëse në Bilancin e vitit 2021 dhe vitit 2022.

*Zbatuar*

**10. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “Ujësjetës Mat” ShA. me NUIS “J.....F” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 729,777,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 729,777,000 lekë.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mat në “Ujësjetës Mat” ShA., në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2019 dhe 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. ***Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) 729,777,000 lekë dhe investori është Bashkia Mat.*** Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksionerëve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël **729,777,000 lekë** përbën shtrembërim të informacionit financiar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 119-133, të Raportit të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetës Mat” ShA me vlerë kontabël **729,777,000 lekë** në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**10.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *në lidhje me rekomandimin e mësipërm Bashkia çdo vit harton pasqyra të konsoliduara dhe llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet me vlerë kontabël 729,777,000 lekë është e përfshirë në Bilancin e UK Mat dhe si e tillë është paraqitur në Pasqyrat e konsoliduara të vitit 2021.*

**Zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 18,402,483 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 18,261,283 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2019 dhe 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Pra llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për **5,700,271 lekë për vitin 2020 dhe 5,037,881 lekë për vitin 2019**, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3.3 “Llogaria 466 Kreditorë për mjete në ruajtje”, në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

**11.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *në lidhje me këtë rekomandim për llogarinë 466 kreditorë për mjete në ruajtje është bërë verifikimi i tyre dhe kategorizimi sipas viteve kur janë krijuar dhe*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

*një pjesë e këtyre garancive janë të trashëguara nga ish Komunitat dhe nga ana e bashkisë nuk disponohet informacion i plotë në lidhje me objektet që u përkasin. Është kërkuar bashkëpunimi nga Dega e Thesarit Mat për identifikimin e objekteve që u përkasin këto garanci dhe më pas do të bëhen njoftimet përkatëse.*

*Zbatuar pjesërisht*

**12. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 19,924,791 lekë, e cila përbëhet nga:

- shpenzime të kryera por të pafinacuara për mallra dhe shërbime në masën 15,212,010 lekë
- shpenzimet për vendime gjyqësore në shumën 3,750,850 lekë;
- shpenzime të tjera për sigurime shoqërore, shëndetësore dhe shpërblim këshilli dhe kryetarë fshatrash por të pa likuiduara në shumën 961,931 lekë.

dhe që janë pasqyruar në llogarinë 486 në shumën **19,924,791 lekë**.

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Mat nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar 3 pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2021 por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020 me vlerë totale **14,330,439 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2021 por me kompetencë vitin 2020, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2020 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me **14,330,439 lekë**. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 42 në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, e cila është nënvlerësuar me 14,330,439 për vitin 2020. Ky sistemim të bëhet duke e transferuar këtë vlerë nga llogaria 41-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

**12.2 Nga verifikimi rezultoi se:** në lidhje me rekomandimin për sistemimin e llogarisë 467 “kreditorë të ndryshëm” duke bërë zbritjen për vlerën 14,330,439 lekë për vitin 2020 bazuar në Udhëzimin e ri nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore” në lidhje me llogarinë 467 të gjitha detyrimet për të cilat paraqitet faturë tatimore janë përfshirë në llogarinë 401-408, përveç rasteve të tjera si shpërblime apo ndihma financiare që paraqiten me bordero pagese.

*Zbatuar*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportit të inventarizimit të aktiveve të institucionit dhe kontratës së shërbimit të pastrimit në Bashkinë Mat, u konstatua:

1.Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, përpara vitit 2018, ka qenë kompania “K.” ShPK me NIPT J.....D dhe administrator z. G. K..

2.Kontraktuesi i shërbimit të pastrimit të Bashkisë Mat, nga data 09.03.2018 deri 31.12.2021 ka qenë kompania “A. G.” shpk me NIPT J.....D dhe administrator të asaj periudhe z. K.M., si dhe administrator aktual z. B. B.. Kjo kompani është përfaqësuar dhe i ka transferuar 100% të detyrimeve kontraktuale nëpërmjet prokurës nr.312 rep, nr.82/2 kol tek kompania “E. 1”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

ShPK me NIPT L.....F dhe administrator z. K. K.. Ky veprim transferimi është bërë në kundërshtim të plotë me kontratën e lidhur mes Bashkisë Mat dhe kontraktuesit “A. G.” ShPK (neni 36.1), pasi në kontratë nuk përcaktohet nënkontraktimi, veprim në kundërshtim me;

- nenin 61 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

- nenin 75 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi në DST nuk përcaktohet nënkontraktimi si opsion i pjesëmarrjes në tender të kontraktorit “A. G.” ShPK.

3. Nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, kontenierët e bashkisë Mat, nuk i janë dorëzuar kontraktuesit “A. G.” ShPK, megjithëse në situacionet e tyre paraqiten zërat e *grumbullimit të mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim*.

4. Në datën 29.06.2019 u janë transferuar kontenierët, me një autorizim të datës 28.06.2019 në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin për ruajtjen e aktiveve, nga kompania “K.” ShPK me administrator z. G. K., tek marrësi në dorëzim z. K. K., ky i fundit administrator i përfaqësueses “E. 1” ShPK si dhe i biri i z. G. K. (referuar statutit të themelimit të shoqërisë).

5. Referuar pikës 3, në popullatën e likuidimeve të faturave të kontraktuesit “A. G.” ShPK për shërbimin e pastrimit të Bashkisë Mat nga data 09.03.2018 deri 29.06.2019, është përzgjedhur kampioni prej 2 muaj (shkurt, mars 2019). Në këtë kampion janë konstatuar situacione me zërat e punimeve *grumbullimi i mbeturinave dhe marrja e tyre nga kontenierët për në vend depozitim*.

6. Në ekstraktin historik të shoqërisë “A. G.” shpk, ekstrakt ky i nxjerrë në datën 04.02.2021 nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në seksionin “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit”, në asnjë rast nuk paraqitet ushtrimi i aktivitetit në territorin e Bashkisë Mat. Gjithashtu kjo kompani nuk rezulton as në regjistrat e biznesit të Bashkisë Mat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 118-132, të Raportit të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për inventarizimin e aktiveve që janë nën përgjegjësinë materiale të Drejtorisë së Shërbimeve, duke përfshirë këtu dhe të gjitha aktivet që i janë dorëzuar shoqërisë A. G. SHPK. Gjithashtu nga ana e Kryetarit të Bashkisë Mat, të ndërmerren hapa konkretë në evidentimin e kushteve në të cilën ka vepruar dhe ekzekutuar kontratën e shërbimit të pastrimit shoqëria A. G. SHPK, në raport me AK Bashkia Mat, duke pasur parasysh evidencat që kanë dalë nga auditimi.

**13.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *në lidhje me rekomandimin për inventarizimin e aktiveve të cilat kanë qenë nën përgjegjësinë e subjektit “A. G.” të pastrimit, i ka përfunduar kontrata që ka pasur me Bashkinë Mat më 31.12.2021 dhe shërbimi i pastrimit i ka kaluar Bashkisë Mat me Sektorin e mbetjeve dhe e gjithë baza materiale ka kaluar në përgjegjësi të Përgjegjëses së Sektorit të Mbetjeve znj. L. K..*

**Zbatuar**

**14. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

“Mjedisi i kontrollit”

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS. Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive.

“Menaxhimi i Riskut”



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk është bërë vlerësimi i riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, duke penguar marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

#### “Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Mat nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT.

#### “Informimi dhe Komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Mat kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por konsultimet publike nuk janë të plota dhe mungon dokumenti i konsultimit publik.

#### “Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Audit i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-32, të Raportit të Auditimit*)

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat me atributet e Kryetarit të GMS në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut të institucionit, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

**14.2 Nga verifikimi rezultoi se:** në lidhje me këtë rekomandim është në faza fillestare, është hartuar regjistri i riskut dhe dërguar në Ministrinë e Financave si dhe po punohet për njohjen nga stafi i ligjit të MFK.

*Zbatuar pjesërisht*

**14.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësive si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

**14.3 Nga verifikimi rezultoi se:** në lidhje me këtë rekomandim është planifikuar një fond në buxhetin e vitit 2023 për blerje të programit buxhetor për pasqyrat financiare por akoma nuk është realizuar procedura e prokurimit.

*Zbatuar pjesërisht*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

**15. Gjetje nga auditimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm, Bashkia Mat, për periudhën objekt auditimi, nuk ka vlerësuar si duhet riskun, duke mos audituar drejtoritë që mbartin risk të lartë. Në këtë mënyrë nuk i ka dhënë siguri të plotë Titullarit të institucionit për realizimin e objektivave.

-Për rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme nuk ka hartuar program të veçantë për auditimin e nivelit të zbatimit të tyre, duke sjellë që Titullari i institucionit të mos informohet mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e kryera;

-Nga NJAB nuk është bërë kontrolli i cilësisë për çdo auditim, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Dy nga audituesit e NJAB nuk janë të certifikuar.

-Gjithashtu dosjet e auditimit nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të Sektorit të Auditit të Brendshëm. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronjat “c” dhe “ç” në nenin 14, shkronja “e” në nenin 16 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 32-37, të Raportit të Auditimit)

**15.1. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lëna, të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

**15.2 Nga verifikimi rezultoi se:** nga njësia e auditimit të brendshëm të Bashkisë Mat nuk është realizuar program i veçantë për zbatimin e rekomandimeve si dhe nuk është kryer kontrolli i cilësisë për çdo auditim për shkak të mungesës së plotë të strukturës me 3 auditues.

*Në proces*

**15.2. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa të menjëhershme për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

**15.3 Nga verifikimi rezultoi se** NJAB Bashkia Mat ka arkivuar dosjet në arkivin e institucionit, por nuk janë aplikuar opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin publik.

*Në proces*

**15.3. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa që punonjësit pa certifikatë të NJAB, të pajisjen me certifikata të auditit të brendshëm, si dhe kryerjen e trajnimeve të vazhdueshme.

**15.4 Nga verifikimi rezultoi se** struktura e NJAB nuk është e plotë me 3 punonjës. Nga dy punonjës aktualisht, njëri është përgjegjës sektori i cili është i certifikuar ndërsa punonjësi tjetër nuk është i certifikuar.

*Në proces*

**15.4. Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Mat, të marrë masa që të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para nivelit drejtues të institucionit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit, në mënyrë që të realizojë misionin e saj, ku veprimtaria e auditimit të brendshëm të funksionojë si veprimtari e pavarur, që mbështet menaxhimin e njësisë vendore për arritjen objektivave, duke ofruar





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime, që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

**15.5 Nga verifikimi rezultoi se** NJAB Bashkia Mat paraqet periodikisht raportet para nivelit drejtues të institucionit por nuk ja paraqet ato Këshillit Bashkiak.

*Në proces*

#### **C.1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Mat në vlerën **21,133,920 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Mat me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve, Sektori i Infrastrukturës, Emergjencës dhe Pronave, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e tarifave të qirave, etj.), veprime dhe moveprime të cilat kanë krijuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën 21,133,920 lekë, nga të cilat 4,682,674 lekë krijuar brenda vitit 2021. Konkretisht veprimet dhe mosveprimet janë konstatuar në marrëdhëniet kontraktuale si vijon: 1 kontratë enfiteoze për pasurinë e llojit “Parku i lojërave”, 5 kontrata për fond pyjor për vendosje të antenave të telefonisë celulare, 1 kontratë për sipërfaqe kullosore për kullotjen e bagëtive, 1 kontratë për fond pyjor për agropylltari, 29 kontrata për fond pyjor për ndërtimin e hidrocentraleve, si dhe 19 kontrata për qiradhënie të banesave sociale. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 142 dhe 154 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 5 në nenin 3, pikën 1 në nenin 16, shkronjën “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronjën “c” të pikës 1, pika 3 në nenin 25, pikën 1 dhe 4 në nenin 34, shkronjë “a” të pikës 2 në nenin 35 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikën 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikën 2, kreu I, në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 21,133,920 lekë, sipas aneksit nr.VII, bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** me shkresën nr. 4181 Prot. datë 05.10.2022, Bashkia Mat ka njoftuar subjektin “F. N.” P.Fizik për arkëtimin e vlerës prej 1,113,369 lekë. Duke mos qenë dakort me njoftimin, Subjekti “F. N.” P.Fizik, me shkresën Nr.Prot.11/1, datë 11.10.2022 ka kundërshtuar njoftimin për arkëtimin detyrimi, njoftim i cili është lënë në fuqi nga ana e Bashkisë Mat me shkresën Nr.Prot.4281/1, datë 09.11.2022. Ndodhur para këtij fakti, subjektin “F. N.” P.Fizik i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Tiranë, çështje e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

cila vazhdon akoma në proces. Për pjesën tjetër të vlerës nuk na u vendos informacion në dispozicion.

*Zbatuar pjesërisht*

#### **C.2.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Mat, konkretisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, u konstatua se në 6 raste për vlerën 14,262,191 lekë, nuk është respektuar radha e likuidimit të tyre, sipas parimit “hyrje e parë-dalje e parë”, si dhe nuk janë kryer likuidimet e plota të detyrimeve, megjithëse Bashkia Mat në fund të viteve 2019-2020-2021 ka patur disponibilitete në thesar.

-Sipas të dhënave të Sektorit Juridik, ka pasur 5 raste të punonjësve që kanë ankimuar në gjykatë ndaj Bashkisë Mat për largime nga puna pa shkaqe të arsyeshme ligjore, për të cilët ka përfunduar gjykimi dhe vendimi ka marrë formë të prerë për shumën 11,638,547 lekë, një pjesë e të cilave i përkasin periudhave të para këtij auditimi. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë, si dhe në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime të Bashkisë Mat ndaj palëve të treta.

Për likuidimin e detyrimit të mësipërm janë kryer pagesa pjesore në vlerën 1,930,648 lekë, që përbëjnë efekt financiar negativ në buxhetin e Bashkisë Mat (praktikisht paguhen dy persona për një vend pune) duke ndikuar në performancën financiare dhe funksionale të institucionit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtorja e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** gjatë hartimit të kërkesave buxhetore janë planifikuar grafiku i likuidimit të detyrimeve të prapambetura (përveç rastit të vendimeve gjyqësore për PAK për të cilat fondet vijnë nga ministria e shëndetësisë dhe çështjeve sociale).

**1.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

**1.3 Nga verifikimi rezultoi se:** Nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Mat u raportua se çështjet që lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore kanë pasur impakt financiar të kushtëzuar edhe nga vendimet gjyqësore, të cilat janë kundërshtuar nga ana e Bashkisë në shkallët e tjera të gjyqësorit dhe për rrjedhojë efektet financiare ndikojnë në të tashmen për buxhetin, ndërsa perspektiva e këtyre efekteve në të ardhmen për buxhetin e bashkisë mbetet e kushtëzuar nga ecuria e shqyrtimeve gjyqësore, pra nga vendimmarrje e shkallës së fundit të gjyqësorit.

**Në proces**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

### C.3.TË ARDHURA TË MUNGUARA.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA janë debitor 425 subjekte në vlerën 39,819,389 lekë (11,036,034 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), *vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat*, e ndarë si më poshtë vijon:

-5 subjekte “Biznesi Vip” debitor në vlerën 5,114,318 lekë

-59 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 13,890,241 lekë

-273 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 16,659,480 lekë

-10 subjekte “Lojra Fati” në vlerën 722,515 lekë

-2 subjekte “Kompani sigurimesh” në vlerën 60,500 lekë

-46 subjekte “Tregtar Ambulant” në vlerën 1,053,335 lekë

-30 subjekte “Institucione” në vlerën 2,319,000 lekë.

-Për debitorët e krijuar më sipër, konstatohet se, nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor, nuk janë ndjekur plotësisht masat shtrënguese me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Kjo situatë është krijuar edhe si rrjedhojë e mospërditësimit të regjistrimit të subjekteve të mësipërme që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mat, ku ka subjekte të cilat megjithëse kanë mbyllur aktivitetin e tyre/ose kanë ndryshuar adresën e aktivitetit, vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën situatë në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76 dhe nenin 114, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pikën 1 në nenin 22, nenin 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; VKB nr.1, datë 04.01.2019, VKB nr.54, datë 24.12.2019 dhe VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 39,819,389 lekë.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *Nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore janë maturuar dhe ju është dërguar Njoftim Vlerësimi dhe fatura. Gjithashtu është bërë përditësimi i regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023. Ndërsa pjesa i përket debitorëve vazhdon të dërgohet Njoftim Vlerësimi si edhe në Muajin Tetor janë bërë urdhër bllokimit të llogarive bankare. Një pjesë e bizneseve paguajnë debinë me këste mujore në UK S.H.A. Nga këto masa janë shlyer detyrimet e prapambetura deri në vitin 2021 në vlerën totale prej 6,572,355 lekë dhe përkatësisht:*

*1 “Biznes Vip” në vlerën 288,225 lekë, mbeten 4 biznese debitorë në vlerën 4,826,093 lekë.*

*Debia e A. S.H.A e viteve vazhdon në proces gjyqësor për hapësirën publike.*

*15 Subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 1,547,053 lekë, mbeten 44 biznese debitorë në vlerën 12,343,188 lekë.*



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

130 Subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 3,918,077 lekë, mbeten 143 biznese debitorë në vlerën 12,741,403 lekë.

1 “Tregtar Ambulant” në vlerën 2000 lekë, mbeten 45 Tregtar Ambulant debitorë në vlerën 1,051,335 lekë.

8 “Institucione” në vlerën 823,000 lekë, mbeten 22 Institucione debitorë në vlerën 1,496,000 lekë.

Përsa i përket kamatëvonesave, njoftimit të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme do të zbatohet në vijimësi si masë shtrënguese deri në urdhër sekuestro.

*Zbatuar pjesërisht*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, për periudhën 2019-2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Mat dhe NJA, vlera debitorë e kategorisë “familjar” është 36,597,002 lekë (26,950,964 lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Mat, e ndarë si vijon:

-5,094 familje debitorë nga 11211 gjithësej, në vlerën 1,018,800 lekë për tarifën e ndriçimit;

-10,676 familje debitorë nga 11211 gjithësej, në vlerën 13,578,900 lekë për tarifën e shërbimit (pastrim, gjelbërim, dekor);

-9323 familje debitorë nga 11211 gjithësej, në vlerën 8,692,984 lekë për taksën e ndërtesës;

-5351 familje debitorë nga 11211 gjithësej, në vlerën 460,480 lekë për taksën e truallit;

-10,666 familje debitorë nga 11211 gjithësej, në vlerën 3,199,800 lekë, për tarifën e infrastrukturës arsimore. Për situatën e mësipërme, nga UK Sh.A., Mat nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë, si dhe nga Bashkia Mat nuk është marrë masë për gjatësimin në masën 50% të vlerës së pa arkëtuar të agjentit tatimor UK Sh.A. Këto veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 5, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 19 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 5, nenin 8, nenin 11 dhe nenin 19 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 4, nenin 6, nenin 8 dhe nenin 17 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK Sh.A., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e përgjegjësisive ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

**2.2 Nga verifikimi rezultoi se:** 95% e kryefamiljarëve paguajnë rregullisht çdo muaj në UK SH.A ku aty gjenden dhe tarifave dhe taksat vendore. Përsa i përket familjarit Bashkia Mat plus detyrimin vjetor, abonentët që kanë debi ndër vite u kanë mbajtur edhe detyrimin që kanë patur ndër vite me një këst mujor nga Muaji Korrik 2022.

*Zbatuar pjesërisht*

**2.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

**2.3 Nga verifikimi rezultoi se:** Bashkia Mat po vazhdon me procesin e përditësimit të regjistrit familjar sipas të dhënave të evidentuara nga terreni me qëllim rritjen e të ardhurave.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

*Zbatuar pjesërisht*

**2.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,597,002 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

**2.4 Nga verifikimi rezultoi se:** në total kanë shlyer detyrimet familje debitore për periudhën 2019-2021 në vlerën 175,589 lekë me faturë dhe 520,750 lekë me këste në UK SH.A nga Korrik 2022 deri në muajin Mars 2023. Kjo debi vazhdon të shlyhet çdo muaj në vazhdim.

*Zbatuar pjesërisht*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se, vlera debitore gjithsej për këtë taksë, krijuar përgjatë periudhës 2019-2021 është 1,933,203 lekë (nga të cilat 567,389 lekë krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Mat. Gjithashtu konstatohet se, regjistrat e tokës nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastër për tokat në disponim dhe përdorim dhe nuk janë bërë njoftim-detyrime për të gjithë fermerët e evidentuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 10 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 10 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 7 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se:** nuk është ngritur grup pune me specialistë të fushës për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore.

Nga ana e Njësive Administrative çdo punonjës i Kadastrës po nxjerr të sakta nga ASHK regjistrat e përditësuar për tokat në disponim dhe përdorim, ku dy Njësi Administrative i kanë dorëzuar dhe konkretisht Njësia Administrative Baz dhe Komsit dhe për Njësitë e tjera pasi të merret një kopje nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore do të hidhen në regjistra dhe do të dërgohen njoftim detyrimet për të gjithë fermerët e evidentuar.

*Zbatuar pjesërisht*

**3.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 1,933,203 lekë.

**3.3 Nga verifikimi rezultoi se:** në total kanë shlyer detyrimet e taksës së tokës bujqësore 948 familje në vlerën 548,124 lekë.

*Zbatuar pjesërisht*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se, vlera debitore për këtë taksë krijuar përgjatë periudhës 2019-2021, për 81 posedues të lejes së legalizimit është 2,726,502 lekë, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat. Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në nenet 90-91 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Theksojmë se, nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

e bëra në nenin 13 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 13 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 10 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,726,502 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *nuk është marrë asnjë masë për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën e mësipërme nga legalizimi i ndërtimeve informale.*

*Pa zbatuar*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se, për gjobat e vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, nga Kryetari i Bashkisë Mat dhe Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në gjykatën përkatëse për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **4,476,742 lekë** në buxhetin e Bashkisë Mat. Mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”; Nenin 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-118, të Raportit të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 4,476,742 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *Për subjektet e mësipërme të cilët rezultojnë debitor nga gjobat e vendosura nga IMT, me datë 03.03.2022 janë dorëzuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë “Kërkesat për lëshim Urdhëri Ekzekutimi”. Pas marrjes së Vendimeve për lëshim Urdhëri Ekzekutimi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” (i ndryshuar), në Ligjin Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; në “Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), në Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 8730, datë 18.01.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor”, (i ndryshuar)”, me datë 30.06.2022 janë dorëzuar dosjet pranë Zyrës Përmbartimore Mat me kërkesën për Ekzekutimin e Vendimeve për Lëshim Urdhëri Ekzekutimi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për ekzekutimin e Titujve Ekzekutiv, Vendimeve të dënimit me gjobë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Mat, për subjektet e mësipërme, duke dërguar edhe dosjet për secilin rast. Deri në datën e mbajtjes së këtij akt verifikimi nuk është bërë asnjë pagesë nga ana e debitorëve.*

*Zbatuar pjesërisht*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi përlllogaritjet për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit për subjektet “Biznesi Vip”, “Biznesi i Madh” dhe “Biznesi i Vogël”, që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, u konstatua se, për periudhën 2019-2021 janë përjashtuar/përlllogaritur gabim taksa e ndërtesës dhe tarifa e shërbimit për subjektet e mësipërme, konkretisht: Për taksën e ndërtesës 10 subjekte “biznes i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

madh”, 40 subjekte “biznes i vogël” dhe 6 subjekte me aktivitet HEC; Për tarifën e shërbimit 42 subjekte “biznes i madh” dhe 10 subjekte me aktivitet HEC, *duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 15,148,685 lekë, në buxhetin e Bashkisë Mat*. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 5 dhe nenin 20 në VKB nr.1, datë 04.01.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2019; Nenin 5 dhe nenin 20 në VKB nr.54, datë 24.12.2019 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2020; Nenin 4 dhe nenin 18 në VKB nr.137, datë 22.12.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacionin (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 15,148,685 lekë.

**6.2 Nga verifikimi rezultoi se:** *përsa i përket pagesës së taksës së ndërtesës kanë paguar si më poshtë vijon:*

*1 HEC në vlerën 95,200 lekë;*

*1 Biznes i madh në vlerën 1,861 lekë*

*3 subjekte biznes i vogël në vlerën 10,170 lekë. Pra në total rezulton se janë paguar 107,231 lekë duke mbetur pa u paguar akoma pjesa tjetër e vlerës.*

**Zbatuar pjesërisht**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se 18 subjekte, që operojnë në territorin në Juridiksionin e Bashkisë Mat nuk është aplikuar saktë tarifa e licencimit, *me pasojë të ardhura të munguara në vlerën prej 18,850,000 lekë për buxhetin e Bashkisë Mat*. Gjithashtu konstatohet se, 14 subjekte për 17 stacione të shitjes së karburanteve, të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, nuk janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, ku 3 prej tyre, nuk janë të regjistruar në QKB, duke operuar në informalitet. Për këtë situatë nuk janë marrë masat e nevojshme, si për njoftimin e tyre për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, ose në të kundërt njoftimin e Inspektoratit përkatës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për bllokimin e aktivitetit, etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4, pikat “i-vi” në shkronjën “ç” në nenin 5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Pikat 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)*

**7.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë të ushtrimit të aktivitetit subjektet të cilat nuk e disponojnë një të tillë. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën/paguar pjesërisht tarifën përkatëse, në vlerën 18,850,000 lekë në total.

**7.2 Nga verifikimi rezultoi se:** ky rekomandim nuk është zbatuar.

**Pa zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

Bashkisë Mat, u konstatua se, për periudhën 2019-2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Mat, 9 operatorë ekonomik të shpallur fitues, nga të cilët vetëm 1 prej tyre ka paguar tarifën e shërbimit dhe 9 nuk e kanë paguar, *duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 504,001 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 37-117, të Raportit të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 504,001 lekë.

**8.2 Nga verifikimi rezultoi se:** subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Mat u janë dërguar Njoftim Vlerësimet dhe kanë paguar përkatësisht:

2.- 140,936 lekë

K. Shpk – 82,500 lekë

N. Shpk - 59,994 lekë

2 . Shpk – 41,250 lekë

E. Shpk – 300,000 lekë

E. Shpk – 300,000 lekë

Rezultoni se nuk kanë shlyer detyrimet 2 operatorë ekonomikë dhe përkatësisht C.R. 2008 shpk dhe R. shpk.

*Zbatuar pjesërisht*

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE.**

I. Bazuar në nenet 111 - 131 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, dhe nenin 15 shkronja (c dhe ç), nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandoj **Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**, shqyrtimin e informacionit për aktin abuziv në lidhje me aktivitetin financiar të shoqërive private si më poshtë:

Subjektet private, pjesë e konstatimeve;

1-“A. G.” shpk me NIPT J.....D,

2-“E. 1” shpk me NIPT L.....F,

Palë të lidhura;

3-“K.” shpk me NIPT J.....D,

4-Bashkia Mat, përfaqësuar në kontratë nga ish Kryetari i Bashkisë z. N. R..

**Nga verifikimi rezultoi se:** Me shkresën nr. 1206/6, datë 18.01.2023 dhe protokolluar në KLSH me nr. 53/20, datë 23.01.2023 Drejtoria Rajonale Tatimore Berat ka kthyer përgjigje pas shqyrtimit që ka kryer për konstatimet e KLSH-së me anë të së cilës ka konfirmuar shkeljet dhe masën administrative “Gjobë në masën 50 %...”

*Zbatuar*

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 –Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Mat





## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe dhënien e masës disiplinore sipas rastit.

**Nga verifikimi rezultoi se:** *ky rekomandim nuk është zbatuar.*

*Pa zbatuar*

### III. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Mat për Projekt Raportin e Auditimit “Për auditimin financiar” dërguar me shkresën nr. 53/16 prot., datë 02.05.2022, rezulton se subjekti i audituar nuk ka respektuar afatin 20 ditor për hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve, si dhe ka njoftuar brenda 6 muajve mbi ecurinë e zbatimit të këtyre masave, në përputhje me kërkesat e nenit 15 shkronja (j) dhe pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, **por nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Mat për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Rekomandimi nr. 2.1:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

*Në vijimësi*

**2. Rekomandimi nr. 5.1:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa për:

-Sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohet kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë dhe duke respektuar rradhën e likuidimit sipas parimit “hyrje e parë – dalje e parë”.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

*Menjëherë*

**3. Rekomandimi nr. 6.1:** Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e druve të prerë në ekonominë pyjore Derjan 2 dhe Mbasdeje, nga punimet për ndërtimin e HEC Sekë dhe Zajs, si dhe lidhjen e akt-marrëveshjes me subjektin “S. H.” për ripyllëzimin e fondit pyjor.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

*Menjëherë*

**4. Rekomandimi nr. 7.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrë masat e nevojshme dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përlogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Rekomandimi nr. 11.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për sistemimin në kontabilitet të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

*Menjëherë*

**6. Rekomandimi nr. 14.1:** Kryetari i Bashkisë Mat me atributet e Kryetarit të GMS në bashkëpunim me Koordinatorin e Riskut të institucionit, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

*Menjëherë*

**7. Rekomandimi nr. 14.2:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

*Menjëherë*

### **C.1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Rekomandimi nr. 1.1:** Kryetari i Bashkisë Mat të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 20,020,551 lekë, vlerë e mbetur.

*Menjëherë*

### **C.3 TË ARDHURAT E MUNGUARA**

**1. Rekomandimi nr. 1.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguroese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj.) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 39,819,389 lekë.

*Menjëherë*

**2. Rekomandimi nr. 2.1:** Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar si pasojë e detyrimeve të krijuara nga puna e dobët e UK ShA., Mat (në rolin e agjentit tatimor) për taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, me qëllim marrjen e



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

përgjegjësi ligjore nga palët dhe shmangien e veprimeve abuzive në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

*Menjëherë*

**3. Rekomandimi nr. 2.2:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të përditësohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

*Menjëherë*

**4. Rekomandimi nr. 2.3:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,597,002 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

*Menjëherë*

**5. Rekomandimi nr. 3.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Tokës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse dhe verifikimit në terren.

*Menjëherë*

**6. Rekomandimi nr. 3.2:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **1,933,203 lekë**.

*Menjëherë*

**7. Rekomandimi nr. 4.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,726,502 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

*Menjëherë*

**8. Rekomandimi nr. 5.1:** Kryetari i Bashkisë Mat në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 4,476,742 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

*Menjëherë*

**9. Rekomandimi nr. 6.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të marrë masat e nevojshme, duke vlerësuar dokumentacionin (kontratë qiraje, dokument pronësie, leje ndërtimi, etj), kryer verifikimet në terren për subjektet e mësipërme, si dhe në vijim, njoftimin për vlerësimin e detyrimit tatimor, si dhe ndjekjen e të gjithë procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 15,148,685 lekë.

*Menjëherë*

**10. Rekomandimi nr. 7.1:** Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet sektorit të licencimit dhe sektorit të taksave dhe tarifave vendore, të marrë masat e nevojshme, për identifikimin dhe pajisjen me licencë të ushtrimit të aktivitetit subjektet të cilat nuk e disponojnë një të tillë. Gjithashtu të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë kryer pagesën/paguar pjesërisht tarifën



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”

përkatëse, në vlerën 18,850,000 lekë në total.

*Menjëherë*

**11. Rekomandimi nr. 8.1:** Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave të nxjerrin njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 504,001 lekë.

*Menjëherë*

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

**E.1** Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 –Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, **i rikërkojmë Kryetarit të Bashkisë Mat** vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe dhënien e masës disiplinore sipas rastit.

**E.2** Nga Kryetari i Bashkisë Mat **kërkojmë** vlerësimin e shkallës së përgjegjësive dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar sipas Planit të masave të miratuara.

*Menjëherë*

*Zbatimi i rekomandimeve për Bashkinë Mat (Formulari nr. 12), në mënyrë tabelore paraqitet:*

Nr	Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Nga këto:				Nga rekomandimet gjithsej sa me dëme ekonomike ose efekt negativ në buxhet ose të ardhura të munguara								
			Pranuar në numër	Zbatuar në numër dhe proces	Zbatuar pjesërisht në numër	Pa zbatuar në numër	Rekomanduar		Pranuar		Zbatuar/ apo proces zbatimi		Në Proces Civil apo Penal në 000/lek	Pa zbatuar (Pa filluar procedura)	
							Nr. per s	Në 000/lekë	Nr. per s.	Në 000/lekë	Nr. per s	Në 000/lekë		Nr. per s	Në 000/lekë
<b>I</b>	<b>NË FUSHËN E LEGJISLACIONIT</b>														
1	Shfuqizim akti														
2	Përmirësim akti														
<b>II</b>	<b>MASA ORGANIZATIVE</b> (Gjithsej, Në vlerë)	20	20	13	6	1									
<b>III</b>	<b>MASA SHPËRBLIM DËMI</b> (Nga të cilat nuk janë kontabilizuar, në Financë)	1	1		1		1	21,133	1	21,133		1,113		20,020	
<b>IV</b>	<b>MASA DISIPLINORE</b> Mase Administrative	1	1	1		1									
<b>V</b>	<b>MASA 3E</b> Nga të cilat: 1 Masa për eliminimin e efektit negativ në fondet publike 2 Masa për eliminimin e efektit negativ në të ardhura të munguara 3 Ulje borxhit tatimor														
<b>VI</b>	Dhe të tjera masa nëse ka. Gjoha APP														

*Për sa më sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

**AUDITUESIT SHTETËRORE TË KLSH-së**



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport Përfundimtar Auditimi “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.01.2022 deri 30.06.2022, Bashkia Mat”**

**E. K.** *(Përgjegjës grupi)*

**S. J.**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**B. D.**